




Public Health
England

NHS

Rreth vaksinës kundër koronavirusit. Çfarë duhet të prisni pas vaksinimit



Vaksina e koronavirusit është një bar që ndihmon në mbajtjen e njerëzve të sigurt nga koronavirusi. Shkencëtarët i kanë testuar vaksinat për t'u siguruar që ato janë të sigurta dhe funksionojnë mirë.



Njerëzit që kanë më shumë të ngjarë të sëmuren shumë nga koronavirusi po e marrin të parët vaksinën. Kjo përfshin shumë njerëz me aftësi të kufizuara në të mësuar dhe ata në një grup në rrezik.



Ju duhet të merrni dy doza vaksinash për të qenë sa më të sigurt. Ju sapo keni bërë dozën e parë të vaksinës. Duhet të siguroheni që të shkoni në takim tuaj të ardhshëm në mënyrë që të jeni sa më të mbrojtur nga koronavirusi.



Pasi të keni bërë vaksinën, mund të mos ndiheni mirë për një kohë të shkurtër. Këto quhen efekte anësore. Efektet anësore zakonisht nuk ju bëjnë të ndiheni shumë keq dhe jo të gjithë i kanë ato.



Efektet kryesore anësore janë:

dhimbje ose sikur keni një grip të lehtë





ndjenjë lodhjeje

dhimbje koke



krahu juaj ndihet i rëndë ose i lënduar atje ku keni bërë vaksinën për 1 apo 2 ditë

ju mund të keni të nxehtë për 1 apo 2 ditë



Nëse keni efekte anësore mund të pushoni dhe të merrni paracetamol për t'ju ndihmuar të ndiheni më mirë.

Do të tregojë në pako sa duhet të merrni.




Efektet anësore zakonisht zgjasin më pak se një javë. Nëse ndiheni sikur po bëheni më keq ose nëse shqetësoheni, telefononi NHS 111. Sigurohuni që t'u tregoni profesionistëve shëndetësorë me të cilët flisni se sapo keni bërë vaksinën tuaj të koronavirusit.

Kjo do t'i ndihmojë ata t'ju japin kujdesin e duhur. Nëse keni mundësi, tregojuni kartën tuaj të vaksinës së koronavirusit.



Nëse keni efekte anësore, përsëri duhet të bëni dozën e dytë të vaksinës. Të bërit e dozës së dytë do t'ju japë mbrojtjen më të mirë ndaj koronavirusit.



Ju nuk mund të infektoheni me koronavirusin nga vakcina. Por është e mundur të infektoheni me koronavirusin para vaksinës tuaj dhe të mos e kuptoni se e keni atë deri pas takimit tuaj të vaksinës.




Shenjat kryesore që mund të keni koronavirus janë:

një kollë e re dhe ju vazhdoni të kolliteni

një temperaturë e lartë


humbni ndjesinë e nuhatjes ose shijes ose keni ndryshim të ndjesisë së nuhatjes apo shijes



Por nëse keni ndonjë shenjë tjetër të koronavirusit, ose keni një temperaturë të lartë për më shumë se 3 ditë, qëndroni në shtëpi dhe rezervoni një testim.



Mund të rezervoni një testim duke telefonuar në 119 ose duke shkuar në faqen e internetit të qeverisë www.gov.uk/get-coronavirus-test



Pasi të keni bërë vaksinën, mund të bëni gjëra që janë normale për ju për sa kohë që ndiheni mirë. Nëse krahu juaj është shumë i lënduar, mund ta keni të vështirë të ngrini gjëra të rënda. Nëse nuk ndiheni mirë ose jeni shumë të lodhur, duhet të pushoni dhe nuk duhet të përdorni asnjë makineri ose t'i jepni makinës.



Mos harroni, bëni një plan për të marrë pjesë në takimin tuaj të dytë të vaksinës.


Takimi juaj i ardhshëm duhet të jetë deri në 12 javë pas takimit tuaj të parë.

Është e rëndësishme të bëni të dy vaksinat e njëjta për t'ju dhënë mbrojtjen më të mirë ndaj koronavirusit.



Ju duhet të merrni një kartë regjistrimi në takimin tuaj të parë - kjo është një kartë që thotë se çfarë lloji të vaksinës keni bërë, kur e keni marrë dhe kur është takimi juaj i ardhshëm.

Mbajeni kartën tuaj të regjistrimit të sigurt dhe sigurohuni që të shkoni në takimin tuaj të dytë.



Nëse nuk jeni mirë, është më mirë të prisni derisa të jeni më mirë që të bëni takimin tuaj të dytë. Ju duhet të përpiqeni të keni takimin tuaj të dytë sa më shpejt të jetë e mundur.

Ju nuk duhet të shkoni në një takim për një vaksinë nëse po vetë-izoloheni, jeni duke pritur një rezultat të testit të koronavirusit ose nëse nuk jeni i sigurt nëse jeni mirë.



Nëse nuk mund të shkoni në takim tuaj, duhet të telefononi në vendin ku po bëni vaksinën tuaj për t'i thënë se nuk mund të vini dhe të rezervoni një takim tjetër.



Vaksina kundër koronavirusit duhet t'ju mbrojtë nga virusi koronavirus, por ka ende një shans të vogël që mund të infektoheni me të. Nëse sërish infektoheni me koronavirusin, nuk duhet të ndiheni aq keq sikur të mos e kishit bërë vaksinën.



Ju nuk do të mbroheni plotësisht nga koronavirusi menjëherë pasi të keni bërë dozën e parë të vaksinës. Bërja e të dy vaksinave do t'ju japë mbrojtjen më të mirë nga koronavirusi.



Ju duhet të vazhdoni të ndiqni udhëzimet për koronavirusin edhe kur keni bërë vaksinën. Kjo përfshin:


- Qëndrimi në një distancë të sigurt nga njerëzit e tjerë
- Larja e duarve shpesh dhe me kujdes
- Vënia e një mbulese fytyre nëse mundeni

Mund të mësoni më shumë rreth rregullave në www.gov.uk/coronavirus




Ne nuk e dimë akoma nëse bërja e vaksinës do t'ju ndalojë ta kaloni koronavirusin te njerëzit e tjerë.

Ju mund të mësoni më shumë rreth koronavirusit në udhëzuesin për lexim të lehtë: 'Një udhëzues për vaksinimin tuaj ndaj koronavirusit' (<https://bit.ly/3asSK9Z>)




Efektet anësore mund të raportoni edhe në faqen e internetit të Kartës së Verdhë të koronavirusit (<https://coronavirus-yellowcard.mhra.gov.uk>) ose duke shkarkuar aplikacionin Yellow Card.

Kjo faqe në internet nuk lexohet lehtë, kështu që ju mund të dëshironi të merrni dikë që t'ju ndihmojë.



Ka gjithashtu më shumë informacion në www.NHS.UK



Vaksina, ndihma për mbrojtjen e personave më të prekshëm.

© E drejta e autorit Crown 2021. Kodi i produktit COV2020307V2ERAL. Shëndeti Publik në Angli numri i portalit 2020617 Albanian. 1p 500 K (APS) SHKURT 2021. Ju mund të porosisni më shumë nga këto broshura këtu www.healthpublications.gov.uk